



Res Publica &lt;qendra.respublica@gmail.com&gt;

2076  
149/1**Kerkese per informacion Nr. Prot 149/22**

koordinatori MAS <koordinatori@arsimi.gov.al>  
To: Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>  
Cc: Alqi Kushi <Alqi.Kushi@arsimi.gov.al>

Fri, Sep 30, 2022 at 1:01 PM

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me anë të së cilës kërkoni informacion lidhur me arsyet e mbylljes së institucionit arsimor parauniversitar privat "Mehmet Akif Ersoy", Tiranë, ju informojmë si vijon:

Në kuadër të kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë dhe vlerësimit të kushteve të licencimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, pranë institucionit arsimor parauniversitar privat "Mehmet Akif Ersoy", Tiranë, janë ushtruar disa kontrolle nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e saj të varësisë. Citojmë:

- Shkresën me nr. 1383/1 prot., datë 21.6.2022, me lëndë "Kthim përgjigje", e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, me anë të së cilës përcillet relacioni mbi gjendjen ndërtimore të objekteve private të paraqitura për marrje licence për hapje të institucioneve arsimore private parauniversitare. Komisioni i vlerësimit ka arritur në përfundimin se subjekti "Mehmet Akif Ersoy", nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 15, datë 12.07.2013, si dhe nuk i ka marrë masat për fillimin e vitit të ri shkollor 2022-2023 nga ana infrastrukture që të shfrytëzojë për mësimdhënie godinën që ndodhet në rrugën Mëzez-Kashar. Shoqëria "Turgut Ozal" të gjitha ambientet nuk i ka përcaktuar sipas udhëzimit në fuqi për institucionin arsimor privat parauniversitar, arsimi i mesëm i lartë "Gjimnaz" nëse ky institucion do të funksionojë Mehmet Akif femra apo Mehmet Akif meshkuj, pasi ky institucion shfrytëzohet nga ana e këtyre nxënësve dhe me konvikt.
- Raportin e Vlerësimit me nr. 1697/9 prot., datë 14.09.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, në të cilin janë pasqyruar të gjitha gjetjet dhe konstatimet pas verifikimeve të kryera pranë institucionit arsimor parauniversitar privat "Mehmet Akif Ersoy", Tiranë. Referuar gjetjeve dhe konstatimeve të shkëlqeve të rënda që përbëjnë mosplotësim të kushteve të licencimit, bazuar në pikën 3, të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, grupi i vlerësimit i ka propozuar ministrit të Arsimit dhe Sportit: "Heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat "Mehmet Akif Ersoy", Tiranë, licencuar me VKM nr. 560, datë 26.08.1996".

Sa më sipër, bazuar në pikën 5, neni 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ministri i Arsimit dhe Sportit i ka propozuar Këshillit të Ministrave projektvendimin "Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy", i cili e zhvillon mësimin edhe në gjuhë të huaj".

Këshilli i Ministrave mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 42 e 70 të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me vendimin nr. 614, datë 22.09.2022, "Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy", i cili zhvillon mësimin edhe në gjuhë të huaj", ka vendosur: "Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy", për nivelin e arsimit të mesëm të lartë, i cili zhvillon mësimin edhe në gjuhë të huaj".

Vendimi nr. 614, datë 22.09.2022 i Këshillit të Ministrave është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 23.09.2022.

**Duke ju falënderuar,**

**Koordinatori MAS**

**From:** Res Publica <qendri.respublika@gmail.com>

**Sent:** Monday, September 26, 2022 12:21 PM

**To:** koordinatori MAS <koordinatori@qarsim.gov.al>

**Subject:** Kerkese per informacion Nr. Prot 149/22

Qendri Respublikë